



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

**Kodi i lëndës: INF 271**

**Lënda: Imazheri**

PROGRAMI I LËNDËS									
Imazheri									
Titullari i lëndës:		Aurela Saliaj Prof. Ascoc. Phd në Pediatri _____							
Ngarkesa:	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
	6 ECTS	Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekt	Total		
		45	0	0	30	0	75	75	150
Tipologjia e lëndës		Disiplinë e formimit karakterizues të programit							
Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti II, Semestri I							
Lloji i lëndës		Me zgjedhje							
Programi i studimit		Bachelor në Infermieri Mami							
Kodi i lëndës		INF 271							
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës		<a href="mailto:aurela.sasliaj@univlore.edu.al">aurela.sasliaj@univlore.edu.al</a>							

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT**

<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Në këtë lëndë studenti merr njohuri teorike dhe praktike për t'u përdorur në aplikimin rutinor të metodave diagnostike e terapeutike imazherike. Gjithashtu kjo lëndë i mundëson studentëve aftësim profesional me qëllim të krijimit të infermierëve të aftë në teknikat imazherike.
<b>Objektivat e lëndës</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>Njohuri bazë mbi imazherinë e sistemeve dhe aparateve të organizmit në gjendje normale.</li><li>Njohuri në metodat e ndryshme diagnostike si një bazë për diagnostikimin dhe trajtimin.</li><li>Parapërgatitja e pacientit për çdo ekzaminim radiologjik dhe asistenca e nevojshme infermierore.</li></ul>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"><li>Të njohin imazherinë e aparateve dhe sistemeve të organizmit.</li><li>Të realizojnë dhe të njohin metodat bazë të ekzaminimit radiologjik .</li><li>Të njohin paraqitjen normale ekografike të aparateve dhe sistemeve.</li><li>Të njohin semiotikën e përgjithshme imazherike të sëmundjeve të organeve të trupit.</li></ul>

**KONCEPTET THEMELORE**

- Imazheria është një specialitet mjekësor që përdor imazhet mjekësore për të diagnostikuar dhe trajtuar sëmundjet e ndryshme.



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

2. Teknikat dhe metodat në imazherinë diagnostike.
3. Imazheria në aparatit e frymëmarrjes.
4. Diagnostika imazherike e sëmundjeve të aparatit tretës dhe urinar.
5. Diagnostika imazherike e sëmundjeve të hapësirës retroperitoneale.
6. Diagnostika imazherike e sistemit osteoartikular.
7. Diagnostika imazherike e aparatit genital femëror dhe imazheria obstetrikale. Anatomia dhe fiziologjia e uterusit.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<p><b>Tema 1</b>–Tehnikat , metodat, lëndët e kontrastit .  <i>Radiografia, fluoroskopia, ekografia,CT, rezonanca magnetike ,etj. Lëndët e kontrastit me barium. Lëndet e kontrastit në uro-angiografi, cistografi, reaksionet që japin dhe kundëringdikimet e tyre, radiografia.</i></p> <p><b>Tema 2</b> –Terminologjia radiografike.  <i>Fluoroskopia tradicionale, tomografia, teknika të tjera radiologjike, imazhet analoge dhe dixhitale.</i></p> <p><b>Tema 3</b> - Proçedurat angiografike.  <i>Angiografia, ekografia, efekti doppler.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë.</p>	<p><i>fq.7-13</i></p> <p><i>fq.13-18</i></p> <p><i>fq.18-22</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 2orë</p>
II.	<p><b>Tema 4</b> – Rrezatimi.  <i>Mbrojtja nga rrezatimi, dëmtimet nga rrezatimi, efektet somatike të hershme dhe të vona.</i></p> <p><b>Tema 5</b> –Njësitë matëse të mbrojtjes nga rrezatimi.  <i>Faktorët e ponderimit Wr të efikasitetit biologjik të rrezatimit dhe njësitë e matjes.</i></p> <p><b>Tema 6</b> –Metodat e ekzaminimit rëntgenologjik.  <i>Rentgenoskopia, Rentgenografia.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë.</p>	<p><i>fq.22-26</i></p> <p><i>fq.27-29</i></p> <p><i>fq.29-32</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 2orë</p>
III.	<p><b>Tema 7</b> -Anatomia dhe fiziologjia e aparatit të frymëmarrjes.  <i>Pleura , ndarja segmentare e mushkërive, vaskularizimi pulmonar.</i></p> <p><b>Tema 8</b> –Aspekti imazherik normal i organeve të frymëmarrjes.</p> <p><b>Tema 9</b> – Semiotika e përgjithshme imazherike e sëmundjeve të organeve të frymëmarrjes.  <i>Ndryshimet në madhësi dhe në formë të fushave pulmonare , ndryshimet në vizatim dhe qartësi të fushave pulmonare.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë .</p>	<p><i>fq.33-36</i></p> <p><i>fq.36-40</i></p> <p><i>fq.40-45</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 2 orë</p>
IV.	<p><b>Tema 10</b> – Ndryshimet e përshkueshmërisë pulmonare.  <i>Atelektazë, disatelektazë, emfizemë.</i></p> <p><b>Tema 11</b> – Diagnostika imazherike e disa sëmundjeve të mushkërive.</p> <p><b>Tema 12</b>– Sëmundjet inflamatore dhe infektive të mushkërive.  <i>Pneumonia lobare, bronkopneumonia, pneumonia stafilokoksike, TBC e pulmonit, bronkoektazia, abcesi etj.</i></p>	<p><i>fq.45-47</i></p> <p><i>fq.47-50</i></p> <p><i>fq.50-59</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë .		<i>Praktikë 2 orë</i>
V.	<b>Tema 13</b> – Sëmundjet parazitare të mushkërive. <i>Ekinokokozat.</i>	<i>fq.59-62</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 14</b> – Diagnostika imazherike e sëmundjeve të mushkërive nga inhalacioni. <i>Pneumokoniozat.</i>	<i>fq.62-64</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 15</b> – Tumoret e mushkërive ( tumoret beninje, tumoret malinje). <i>Dëmtimet traumatike të mushkërive,adenoma bronkiale, karcinoma bronkiale centarle dhe periferike.</i>	<i>fq.64-70</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë.		<i>Praktikë 2 orë</i>
VI.	<b>Tema 16</b> – Anatomia dhe RO / anatomia normale e aparatit tretës. <i>Ezofagu, stomaku, duodeni, zorra e hollë, zorra e trashë.</i>	<i>fq.70- 73</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 17</b> - Teknikat dhe metodat e ekzaminimit imazherik. <i>Endoskopia, ekzaminimi direkt- grafia direkte</i>	<i>fq.73- 75</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 18</b> –Teknikat radiologjike konvencionale. Ekzaminimet me lëndët e kontrastit. <i>Tomografia e kompjuterizuar, rezonanca magnetike.</i>	<i>fq.75-77</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë.		<i>Praktikë 2 orë</i>
VII.	<b>Tema 19</b> – Diagnostika imazherike e sëmundjeve të ezofagut. <i>Keqformimet, akalazia, variçet, ezofagitet, strikturat, trupat e huaja në ezofag.</i>	<i>fq.77-79</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 20</b> – Tumoret e ezofagut. <i>Tumoret beninje mukozale , formacionet tumoroze submukozale,tumoret malinje.</i>	<i>fq.79-81</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë
	<b>Tema 21</b> – Diagnostika imazherike e sëmundjeve të stomakut. <i>Keqformime si mikrogastria, atrezia, stenoza hipertrofike e pilorittrupat e huaj radioopake dhe rentgenotransparente, ulcerat, tumoret e stomakut, leiomioma,polipet, tumoret malinje.</i>	<i>fq.81-88</i>	
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë.		<i>Praktikë 2 orë</i>
VIII.	<b>Tema 22</b> – Diagnostika imazherike e sëmundjeve të zorrës së trashë. <i>Atrezia , apendisiti, divertikujt, morbus Crohn, tumoret e zorrës së trashë, indikacionet e ekzaminimeve diagnostike dhe të radiologjisë intervencionuese, raddioterapisë.</i>	<i>fq.89-96</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 23</b> – Diagnostika imazherike e sëmundjeve të mëlçisë. <i>Anatomia dhe fiziologjia e heparit, anomalitë e pozicionit dhe variacionet e formës së heparit, tumoret e heparit, sëmundjet parazitare, radiologjia intervencionuese dhe radioterapia.</i>	<i>fq.97-109</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 24</b> – Diagnostika imazherike e patologjive të pankreasit.dhe shpretkës. <i>Anatomia dhe fiziologjia, ekografia dhe CT, pankreatitet, tumoret e pankreasit, radiologjia konvencionale dhe direkte.</i>	<i>fq.110-116</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë.		<i>Praktikë 2 orë</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
IX.	<b>Tema 25</b> – Metodat e ekzaminimit imazherik. <i>Ro/grafia e thjeshtë, urografia endovenoze, ekografia, CT,pielografia,cistografia retrograde, RM , anatomia fiziologjia dhe rentgenoanatomia e aparatit urinar.</i>	<i>fq.116 -122</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 26</b> – Sëmundjet e veshkave dhe ureterëve. <i>Anomalitë,fuzionidhe numuri,ektopitë, distopitë ose anomalitë e pozicionit, veshka në formë patkoi, keqformimet parenkimale, anomalitë e rrugëve ekskretore,sëmundjet inflamatore të veshkave, kalkulozat, tumoret renale, uropatitë obstruktive.</i>	<i>fq.122 -134</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 27</b> – Sëmundjet e vezikës urinare dhe uretrës.Inflamacionet. <i>Cistitet, kalkulozat, tumoret renale, stadet e tumorit.</i>	<i>fq.135-138</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë.		<i>Praktikë 2 orë</i>
X.	<b>Tema 28</b> – Metodat e ekzaminimit imazherik . <i>Ekzaminimi direkt radiografik i abdomenit, Urografia, CT, ekografia, RM dhe metoda të tjera.</i>	<i>fq.138-140</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 29</b> – Anatomia dhe fiziologjia e hapësirës retroperitoneale.	<i>fq.140-141</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 30</b> – Sëmundjet e hapësirës retroperitoneale dhe diagnostikimi i tyre. <i>Proceset inflamatore, tumoret retroperitoneale.</i>	<i>fq.141-144</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë.		<i>Praktikë 2 orë</i>
XI.	<b>Tema 31</b> - Metodat e ekzaminimit imazherik . <i>Radiologjia konvencionale, CT, RM, densitometria, shintigrafia, ekografia, artrografia.</i>	<i>fq.145-148</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 32</b> –Anatomia , fiziologjia dhe rentgenanatomia <i>Njësti funksionale të kockës, dhe stadet e osifikimit të kockave.</i>	<i>fq.149-151</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 33</b> –Semiotika imazherike e sëmundjeve të kockave dhe artikulacioneve. <i>Ndryshimet sasiore dhe cilësore,Lezionet traumatike, sëmundjet infektive të kockave(osteomieliti), tumoret beninje( osteoma dhe osteoma osteoide) të kockave, tumoret malinje (osteosarkoma paraosale, multicentrike,centrale),</i>	<i>fq.151-161</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë.		<i>Praktikë 2 orë</i>
XII.	<b>Tema 34</b> – Pamjet ekografike normale të pelvisit. <i>Skanimi i uterusit, pozicioni i uterusit, metoda abdominale dhe transvaginale ekzaminimit.</i>	<i>fq162 -167</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 35</b> – Pamja normale ekografike e endometrit. <i>Matja e trashësisë së endometrit, adenomioza dhe endometrioza, kanceri cervikal, anomalitë morfologjike të lindura,hiperplazia e endometrit, polipi dhe kanceri endometrik.</i>	<i>fq 168-173</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 36</b> – Sindromi Asherman. <i>Fibromat, leiomyosarkoma, ovula Naboth.</i>	<i>fq 174-176</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë		<i>Praktikë 2 orë</i>
XIII.	<b>Tema 37</b> – Patologjitë e uterusit në shtatzani.	<i>fq 176-179</i>	Leksion 1 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Kontraksion miometri, leiomioma, insuficiencë cervikale.</i>  <b>Tema 38</b>– Vezoret. Sistemi i qarkullimit të gjakut të vezores.  <i>Anatomia normale, topografike, ekografike, hilusi i vezores, paraqitja normale e vezores, vezore e pjekur, vezore postmenopauzale.</i>  <b>Tema 39</b>– Patologjitë ovariale.            Cistet ovare, folikulare, hemoragjike, dermoide, tumoret epiteliiale, tumore të gjëndrave embrionale,</p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë</p>	<p style="text-align: center;"><i>fq 179-182</i></p> <p style="text-align: center;"><i>fq 183-191</i></p>	<p style="text-align: center;">Leksion 1 orë</p> <p style="text-align: center;">Leksion 1 orë</p> <p style="text-align: center;"><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XIV.	<p><b>Tema 40</b>– Tumoret e krahut të jashtëm të ligamentit.  <i>Fibromat, tumore estrogen aktiv, tumorët androgen aktiv.</i>  <b>Tema 41</b> - Kanceri i vezoreve.  <i>Stadet klinike të kancerit të vezoreve, përcaktimet doppler, anatomia normale e tubit uterin, sëmundjet inflamatorë të pelvisit,</i>  <b>Tema 42</b>–Fazat e ciklit menstrual, ovulacioni dhe paraqitja e mukozës gjatë ciklit menstrual.  <i>Ciklet spontane, ciklet e stimuluar.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë.</p>	<p style="text-align: center;"><i>fq 192-194</i></p> <p style="text-align: center;"><i>fq 194-198</i></p> <p style="text-align: center;"><i>fq 198-203</i></p>	<p style="text-align: center;">Leksion 1 orë</p> <p style="text-align: center;">Leksion 1 orë</p> <p style="text-align: center;">Leksion 1 orë</p> <p style="text-align: center;"><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XV.	<p><b>Tema 43</b> – Ndjekja e rritjes dhe zhvillimit të fetusit .  <i>Diagnostikimi i barrës ekografikisht, shtatzania e hershme, saku gestacional, metoda abdominale, transvaginale, kalkulimi i volumit të sakut gestacional .</i>  <b>Tema 44</b>– Paraqitja ekografike në tremujorin e parë.  <i>Amniosi, placenta, matja e CRL, shtatzania binjake, uterus i bikorn, membrana amniotike.</i>  <b>Tema 45</b>– Biometria themelore bazë .  <i>Biometria bazë e tremujorit të dytë dhe paraqitja grafike, trupi i fetusit, struktura dhe mënyra e matjes.</i></p> <p><b>Praktikë mësimore</b> në pavionin e Imazherisë.</p>	<p style="text-align: center;"><i>fq 204-210</i></p> <p style="text-align: center;"><i>fq 211-216</i></p> <p style="text-align: center;"><i>fq 216-224</i></p>	<p style="text-align: center;">Leksion 1 orë</p> <p style="text-align: center;">Leksion 1 orë</p> <p style="text-align: center;">Leksion 1 orë</p> <p style="text-align: center;"><i>Praktikë 2 orë</i></p>

**FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE**

<b>FREKUENTIMI:</b>	<p>Kyçi i një edukimi të suksesshem është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit).            Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>					
<b>KONTROLLI I VAZHDUESHËM</b>	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi I	Java 7/8	Leksioni 1-15	30 pikë	Provimi me	pyetje me



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

					shkrim	shtjellim dhe pyetje quiz
	Provimi final	Fundi i semestrit	Leksioni 16-45	60 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Rastet klinike	10 pikë	Prezantim me gojë	Raportim rasti /
<i>*Detyra e kursit - Do të jetë në formën e një projekti klinik që do të nisë në fillim të semestrit. Studentët do të përshkruajnë rastet më të shpeshta të diagnostikave imazherike dhe të teknikave dhe metodave në imazherinë diagnostike, që hasin në praktikë, duke i krahasuar me përshkrimet teorike të patologjive. Një pjesë e punimeve do të prezantohen dhe në PPT.</i>						
Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:						
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
	5	6	7	8	9	10

LITERATURA	
<b>Literatura bazë e detyruar</b>	<b>"Radiologjia Imazheri diagnostike"</b> -2007 Dr.Maksim Gega, Dr.Brunilda Mersini (Fakulteti i Infermierisë- UV)
<b>Literatura e rekomanduar</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>○ Imazheri' Krenar Preza, 2008 (Fakulteti i Mjekësisë - UT)</li><li>○ "Imazheria klinike për infermierinë" Maksim Gega 2005 (Fakulteti i Shëndetit Publik – UV)</li><li>○ "Merrills Atlas of Radiographic Positioning &amp; Procedures " Bruces W. Long, Barbara J. Smith and Eugene D. Frank, 2007</li><li>○ Learning Radiology E-Book: Recognizing the basics. 3rd Edition, ISBN-13: 978-0323328074.</li><li>○ Radiologic and imaging nursing: Scope and standarts of practice (American Nurses Association). First Edition ISBN-13: 978-1558105072, ISBN-10: 1558105077.</li></ul>

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS	
<b>Dispozita:</b>	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjate procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuar.
<b>Vonesat</b>	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

<b>Sjellja profesionale e studentit</b>	<p>Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.</p>
<b>Integriteti akademik dhe e drejta e autorit</b>	<p>Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.</p>